



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE SIGURISË
PUBLIKE

Nr. 1212/1 prot.

Tiranë, më 15.05.2026

Lënda: Dhënie mendimi mbi marrëveshjen me Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për të dhënat e regjistrimit të emrit të pasagjerit (PNR)

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr.3470/3 prot., datë 29.04.2026, protokolluar me tonën me nr.1212 prot., datë 04.05.2026, me anë të të cilës dërgoni për mendim “Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për transferimin dhe përdorimin e të dhënave të regjistrimit të emrit të pasagjerit” (në vijim “projekt marrëveshja”), si dhe relacionin shpjegues të saj.

Nga shqyrtimi i materialit të dërguar, vërejmë se parashikohet nënshkrimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare ndërmjet shteteve palë, me qëllim parashikimin e masave që garantojnë sigurinë e përpunimit të të dhënave PNR, në kuadër të bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit.

Bazuar në nenin 70, në pikën 1, të nenit 71 të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”), si dhe Vendimit nr.1, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përcaktimin e shteteve që sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, Mbretëria e Bashkuar (përfshirë Irlandën e Veriut), konsiderohet vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se, procesi i transferimit të informacionit dhe të dhënave të regjistruara të pasagjerëve (PNR) ndërmjet palëve, legjitimohet pa ndonjë autorizim të veçantë, kur autoritetet kompetente të shteteve palë sigurojnë nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave, në përputhje me parimet e përgjithshme për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Për sa më sipër, duke qenë se projekt marrëveshja parashikon nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare ndërmjet shteteve palë, si dhe në të janë referuar rregullat dhe parimet bazë mbi

mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit e vlerëson projekt marrëveshjen të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi